



## KOMPANISË SË SIGURIMEVE "PRISIG" SH.A.

Bazuar në nenin 57 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1. dhe paragrafin 8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-092, lidhur me nenin 29.8 paragrafin 1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi I rrugës në Lagjen Hajdaraj - Fshati Koliq - Lot 3" me nr. të prokurimit 616-22-1552-5-1-1, autoriteti kontraktues-Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit parashtron:

### KËRKESË

Për Konfiskimin e sigurimit të tenderit bazuar në të dhënat si në vijim:

Siguruesi, adresa:	K.S. "PRISIG" sh.a., 10000, Prishtinë
Data e sigurimit të tenderit:	15.07.2022
Nr. i polices së sigurimit:	0009685
Shuma:	21,940.42 Euro
I siguruari, adresa:	BASHKIMI METI shpk - rr. Zija Shemsium 3A/1, Prishtinë
Nr. unik identifikues:	811336529
Emri i përfituesit, adresa:	Komuna e Prishtinës, Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë
Emri i bankës së përfituesit, adresa:	Banka Qendrore e Kosovës, Rr. "Garibaldi" Nr. 33, Prishtinë
IBAN dhe SWIFT CODE të përfituesit:	IBAN: XK05 1000 6502 3000 0067 SWIFT: CBRKXKPRXXX

### Arsyetim

Operatori ekonomik: BASHKIMI METI shpk - rr. Zija Shemsium 3A/1, Prishtinë nuk ka zbatuar kontratën dhe kushtet e saj sipas specifikimit teknik. Komisioni për Menaxhim të Kontratës ka konstatuar që me konstatim për ndërprerje të kontratës me nr. 616-22-1552-5-1-1/C837, të datës: 24.08.2023, i cili nuk e ka realizuar kontratën sipas specifikacionit teknik.

Përmes nenit 29.8 paragrafit 1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcaktohet se "AK do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në situatat e mëposhtme:  
a. Në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK dhe/ose kërkon që AK të shkaktoj shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës së tillë".

Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga autoriteti juaj që të ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për konfiskimin e menjëhershëm të sigurisë së tenderit sipas të dhënave më sipër në këtë kërkesë.



**Visar SHEHU**


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Bashkangjitur:**

- Sigurimi i ekzekutimit të tenderit (SIGKOS);
- Konstatimin nga Komisioni për Menaxhim të Kontratës;
- Kontrata e nënshkruar me nr. 616-22-1552-5-1-1/C837, të datës: 14.07.2022.

**Prishtinë, 13.09.2023**

1350 Flamuri



Datë/a:	11.09.2023
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Zyrtarin Kryesor Administrativ - z. Përparim Rama
CC:	Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave
Përmes/Preko/Through:	Departamentit për Prokurim
Nga/ Od/ From:	U.D. i Departamentit për Prokurim - z. Visar Shehu
Tema/ Subjekat/Subject:	Akt Përcjellës - Vendim për Ndërprerje të Kontratës

Me anë të këtij akti ju përcjellim Vendimin për Ndërprerje të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

**“Ndërtimi I rrugës në Lagjen Hajdaraj - Fshati Koliq - Lot 3” ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521**

---

Adresa:Rr. UÇK-2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon:+381(0)38/230-900  
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova - Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština - Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenint 81 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-42, në bazë të nenint 61 par.26, 27, 28 dhe 29 i Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe në bazë të kontratës së lidhur me datë 13.01.2019 ndërmjet Operatorit Ekonomik: " BASHKIMI-METI " SH.P.K., Zija Shemsi. 3A/1 Prishtinë, me numër të biznesit: 811336529, me pronar: Afrim Beka dhe Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.09.2023, palët arritën këtë:

**VENDIM PËR NDËRPRERJEN E KONTRATËS ME TITULL**  
**"Ndërtimi I rrugës në Lagjen Hajdaraj - Fshati Koliq - Lot 3"**  
**ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521**

Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik me datë 14.07.2022, kanë lidhur kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit:

**"Ndërtimi I rrugës në Lagjen Hajdaraj - Fshati Koliq - Lot 3"**  
**ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521**

Me ç'rast pas konstatimit nga Menaxheri i Kontratës z. Besim Qelaj, Mbikëqyrësi i menaxhimit të Kontratës znj. Hyrishahë Morina dhe anëtarët e organit mbikëqyrës z. Hazir Krasniqi dhe z. Behxhet Gashi se Operatorëve Ekonomik nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara nga komuna qysh nga fillimi dhe gjithashtu nuk i ka respektuar rekomandimet e Komisionit për menaxhim të kontratës sipas kushteve të kontratës dhe përshtimit të çmimit.

Kompania ka qene neglizhuese në vazhdimësi dhe shumë e papërgjegjshme pasi qysh nga fillimi ka pasur pretendime që të distancohet nga përmbushja e kontratës.

**Provë: Konstatimi i Komisionit për Menaxhim të Kontratës të datës: 02.09.2023, të dërguar me email zyrtar me datë: 11.09.2023**

Poashtu Departamenti i Prokurimit do të filloj procedurën për inicimin e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit sipas kushteve të kontratës.

Kjo marrëveshje ndërmjet palëve është arritur në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktues në bazë të kushteve të veçanta të kontratës.

**Të iu dërgohet:**


*Operator Ekonomik: " Bashkimi-Meti " SH.P.K*

*Komisionit për Menaxhim të Kontratës*

*Departamentit të Prokurimit*

**Aprovuar nga:** Departamenti i Prokurimit

Visar Shehu (Ushtrues Detyre i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit)



**Aprovuar nga:** Kryetari i Kryeqytetit - Komuna e Prishtinës

Përparim Rama (Zyrtar Kryesor Administrativ)



Prishtinë

11.09.2023.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Datë/a:	02.09.2023
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Dëpartamentin e Prokurimit, Komuna e Prishtinës
CC:	Qendra për komunikim me qytetarë Në lëndë
Përmes/Preko/Through:	Krenar Xhafi, Drejtor
Nga/ Od/ From:	Menaxheri i kontratave Besim Qelaj  Mbikqyrësi i menaxherit Hyrishaqe Morina  Organi mbikqyrës: Hazir Krasniqi Behgjet Gashi
Tema/ Subjekti/Subject:	Rekomandim për ndërrime të kontratës për OE "Bashkimi Meti" SH.P.K.

Përmes këtij akti përcjellës nga Drejtoria e Investimeve të Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave për kontratën "Ndërtimi i rrugës në lagjen Hajdaraj-fshati Koliq-lot 3. me Nr.prokurimi 616 22 1552 511 të datës 15.07.2022" po u'a dërgojmë rekomandimin për shkëputje të kontratës për OE "Bashkimi Meti" SH.P.K. Zija Shemsiu 3A/1 Prishtinë me numër të regjistrimit të biznesit 811336529

**Këtij akti i bashkëngjesin:**

- Raportin e nënshkruar nga menaxheri i kontratës, mbikqyrësi i menaxherit dhe organi mbikëqyrës;
- Komunikimet me e-maila



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## **Rekomandim për ndërprerje të kontratës, konfiskim të sigurimit të garancionit të tenderit**

Rekomandim në lidhje me kontratën "Ndërtimi i rrugës në lagjen Hajdaraj-fshati Koliq-lot 3. me Nr.prokurimi 616 22 1552 511 të datës 15.07.2022

**Emri i Operatorit Ekonomik** : "Bashkimi Meti " SH.P.K. Zija Shemsiu 3A/1 Prishtinë me numër të regjistrimit të biznesit 811336529

### **Arsyet e ndërprerjes**

Me datën: 05 Korrikë 2022 kemi punuar Planin e Menaxhimi të kontratës, të cilin e kemi nënshkruar dy palët dhe e kemi ngarkuar në sistemin elektronik e-prokurimi.

Plani dinamik i realizimit të kontratës ka qenë 120 ditë.

Data e fillimit të punimeve ka qenë 02 Gushtë 2022 dhe përfundimit të punimeve të parapara 02.12.2022

Punimet janë ndërprer plotësisht me 26.09.2022 deri me 08.10.2022 për shkak të vdekjes në familje (vdekjes së vllaut të punëkryesit). Për shkak se ndërtimi i projektit ka qenë e paraparë të ndërtohet në një zonë malore në Koliq dhe temperaturat kanë qenë shumë të ulëta, punime janë ndërprer me 10.11.2022. Me datën: 04.05.2023, kanë rifilluar punimet në këtë kontratë dhe deri me 23.08.2023 punimet nuk kanë përfunduar ende, kemi mbajtur disa takime me përfaqësuesit e kompanisë "Bashkimi Meti " SH.P.K ku i fundit ka qenë me datë 16.08.2023 ku kemi dakordur që të gjitha punimet të përfundojnë deri me 23.08.2023, me datë 24.08.2023 menaxheri i projektit ka dalë në terren dhe ka konstatuar që punimet nuk kanë përfunduar plotësisht ende nuk është bërë shtresë asfalti i cili nuk ka qenë pranuar, bankinat janë punuar në formë të ndryshme dikund mungojnë plotësisht dikund janë punuar nga dheu i kanalit e në disa pjesë është grumbullu material stabilizues 0-63 mm dhe 0-31 mm i cili ka qenë i vendosur me herët në terren, në këtë formë është bërë punimi i bankinave, në terren janë vendosur pahi elastike të vjetra-te përdorurura të cilat janë të pa pranueshme dhe janë në kundërshtim me kushtet e kontratës. Nuk janë vendosur në tersi sinjalizimi vertikal (POS 6.3)

Me datën 24.08.2023, përmes e-mailit kemi njoftuar punëkryesin për ndërprerjen e të gjitha punimeve dhe se lënda do të dërgohet zyres së prokurimit për procedurë të metutjeshme

## Veprimet për shmangje të ndërprerjes

Qe nga fillimi i kemi kërkuar dinamik per përfundimin e punimeve dhe pas përfundimit te sezonit verer kemi njoftuar kompanin se eshte duke e tejkaluar planin dinamik,per ket arsye kemi kërkuar edhe takim me punekryeresin ne zyrën e drejtorit per rritjen e dinamikes së punimeve ne menyre qe te mos vie deri te rekomandimi per nderpreje te kontratës ne menyre te njeaneshme, konfiskim te sigurimit te tenderit sipas vlerës 10% të kontratës dhe klasifikimin si OE i papërgjegjshëm per mos përmbushje te detyrimeve dhe obligimeve qe dalin nga kontrata.

## Baza kontraktuale për ndërprerje

Në bazë të nenit 19 nenit 36 dhe 37 të kontratës, shkelja dhe shkëputja e kontratës Ekip Menaxherial nga Autoriteti Kontraktues njofton se Operatori Ekonomik ka dështuar ti përmbush detyrimet dhe përfundoj punimet sipas kontratës.

### Kostoja nga ndërprerja

- Çmimi total i punimeve sipas kontratës: 219,404.20 €
- Të paguara deri më tani janë 153,469.80 €
- Mbeten per pagës edhe 43,143.50 €

Menaxher i projektit: Besim Qelaj

Mbikqyrës i menaxherit: Hyrisha Morina

Organ Mbikqyrës: Hazir Krasniqi

Behxhet Gashi

Datë: 02.10.2023



## Besim Qelaj

---

**From:** Besim Qelaj  
**Sent:** Monday, August 28, 2023 4:12 PM  
**To:** 'Bashkimi Meti'  
**Cc:** Krenar Xhaferi; Hazir Krasniqi; Behxhet Gashi; Irfete Zejneli; Visar Shehu  
**Subject:** Njoftim

Përshëndetje

Në e-mail e datës 12.08.2023 ju është sqaruar pse situacioni juaj nuk mund të procedohet dhe në këtë e-mail I keni të gjitha sqarimet e nevojshme, me kërkesën e juaj është caktuar termin me drejtorin dhe është mbajtur takim në zyrën e drejtorit më 16.08.2023 dhe ju është bërë e qartë që afati i fundit i punimit të gjitha punimeve është data 23.08.2023 si dhe ju janë dhënë sqarimet pse situacioni nuk mund të procedohet tutje, më datë 24.08.2023 ju është dërguar e-mail për nderprerjen e të gjitha punimeve pasi keni kaluar afat ligjor për punimin e punimeve dhe lenda do të dërgohet zyres së prokurimit për procedurën e metutjem pasi punimet nuk kanë përfunduar ende, e as nuk ju keni përmbajtur zotimeve të marra në takimin me drejtorin.

Unë nuk mundem të ju caktoj termin për takim me drejtorin kur ju e dëshironi unë i adresoj kërkesën tuaj te drejtori por pasi që drejtori e ka agjendën e vet dhe për këtë duhet të presim nga drejtori që ai të na caktoj ditën, datën dhe orën kur ai mund të na pret në takim. Sa për takim me menaxherin e projektit unë jam i gatshëm nesër në ora 14 të ju pres në takim.

**Besim Qelaj**

Inxhinier i Ndërtimitarisë

Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë rrugore

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

Komuna e Prishtinës

e-mail: [besim.q.qelaj@rks-gov.net](mailto:besim.q.qelaj@rks-gov.net)

tel: 038 225 060

mob: +383 45 906 941

**From:** Bashkimi Meti <ntp.bashkimimeti@gmail.com>

**Sent:** Monday, August 28, 2023 2:41 PM

**To:** Besim Qelaj <besim.q.qelaj@rks-gov.net>

**Cc:** Krenar Xhaferi <Krenar.Xhaferi@rks-gov.net>; Hazir Krasniqi <Hazir.Krasniqi@rks-gov.net>; Behxhet Gashi <Behxhet.Gashi@rks-gov.net>; Irfete Zejneli <Irfete.Zejneli@rks-gov.net>; Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>

**Subject:** Kërkesë

Të nderuar,

Ju uroj një vikend të mbarë. Po ju shkruajmë referuar email që kemi pranuar nga ana e juaj për ndërtimin e rrugës në lagjen Hjadaraj me nr. të prokurimit 616 22 1552 5 1 1, të ndëruar është hera e tretë se ju shkruajmë email dhe kërkojmë një takim me ju, pra me drejtorin dhe menaxherin e kontratës, mirëpo një gjë e tillë s'ndodh. Kjo është një neglizhencë nga ana e juaj për të dalë dhe për të përmbjllur kontratën, sepse në kërkesën për mbyllje të kontratës e kemi dërguar së paku që një muaj, asnjherë nuk na kemi thirr nga ana e juaj gjatë këti muji që të dalim dhe verifikojmë senet në terren që janë përfunduar, pos keni marrë një vendim për shkëputje të kontratës që është totalisht e papabzë kause të gjitha senet që janë kërkuar nga ana juaj për tu realizuar në projekt, të gjitha janë bërë.

Ju jeni duke dëmtuar kompaninë tonë.

***BASHKIMI METI SH.P.K***

*The Road Infrastructure Company*

*Adress: Prishtinë, Kosove*

*Tel: (+383) 44 215 385*

*Faks: (+383) 38 728 034*

*[ntp.bashkimimeti@gmail.com](mailto:ntp.bashkimimeti@gmail.com)*